



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.07.2024, të parashtruar nga Grupi Operatorëve ekonomik **Marisa Sh.p.k. & Toifor Sh.p.k. & NSHT Viktory Com**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike**", Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit Operatorëve ekonomik **Marisa Sh.p.k. & Toifor Sh.p.k. & NSHT Viktory Com**, e dt.01.07.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike**", Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.06.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: **24.06.2024**;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Grupi Operatorëve ekonomik **Marisa Sh.p.k. & Toifor Sh.p.k. & NSHT Viktory Com**, me dt.01.07.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Ri-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike**", Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.07.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ju si Grupi i Operatorëve Ekonomik jeni eliminuar sepse për produktet për pozicionet :193, 197, keni dorëzuar një specifikim teknik apo test raport për një produkt që bazuar në testraportin e këtij produkti vërehet qartë se nuk është sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe parapasës. Sipas kërkesave të dosjës së tenderit dhe paramasës në pozicionin 193 dhe 197 kërkohet.

Pozi.-193-Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriçues LED-LAMBARIO -LT33-09422 ose e ngjajshme me karakteristika minimale:

Fuqia e trupit ndriçues LED≥90W

Puna në temperaturë:≥-20 °C deri +40 °C

Faktori i fuqisë:≥0.90

Specifikimi Fotometrik:

Fluksi i dritës: ≥10800lm

CRI: Ra≥70

Ngjyra e temperaturës –Natyrle:4000-5000K

Specifikimi Mekanik:

Mbrojtja :≥ IP65-IK08

Garancioni:≥5 vite

-Ndërsa sipas test raportit të prezantuar nga OE:

Fuqia e trupit ndriçues: 51.42W me e vogël se kërkesa ku kurkohet e barabart ose me e madhe se 90W

Fluksi i dritës 6753.3 lm, me e vogël se kërkesa ku kërkohet e barabartë ose më e madhe se 10800 lm

Pozi.-197.Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriçues LED-LAMBARIO -LT45-09122

ose e ngjajshme me karakteristika minimale:

Fuqia e trupit ndriçues LED≥100W

Dimensionet:≥ø300x135x75mm

Puna në temperaturë:≥-20 °C deri +40 °C

Specifikimi Fotometrik:

Fluksi i dritës: ≥9000lm

Ngjyra e temperaturës –Natyrle:4000-5000K

Specifikimi Mekanik:

Mbrojtja :≥ IP65

Garancioni:≥2 vite

-Ndërsa sipas test raportit të prezantuar nga OE:

Fuqia e trupit ndriçues: 51.42W me e vogël se kërkesa ku kurkohet e barabart ose me e madhe se 100W

Fluksi i dritës 6753.3 lm, me e vogël se kërkesa ku kërkohet e barabartë ose më e madhe se 9000 lm

Ju si Grupi i Operatorëve Ekonomik keni prezantuar Kontratë mbi vepër për inxhinierin e Makinerisë për një projekt tjetër “Ndërtimi i objekteve në K.e FSK-së në Gjakovë,Beishë dhe Melenicë në ndarë tri pjesë, që është në kundërshtim me kërkesat e FDT-së.


Pretendimet e juaja për GOE Joss Krasniqi –Bazë & BerishaCom & Fonderia E & E

Pretendimi juaj se autorizimet janë me data më të vjetra se korrigjimi i dosjes nuk qëndron, sepse ky është i njëjti aktivitet dhe nuk ka ndryshim në paramas dhe produkte edhe pse është bërë korrigjimi i dosjes;

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;